



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 7 nëntor 2016
Nr. ref.:RK997/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI72/16

Parashtrues

Byroja Kosovare e Sigurimit

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës, Rev. nr. 264/2015, të 9 dhjetorit 2015**

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Byroja Kosovare e Sigurimit, me adresë në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës), e përfaqësuar nga përfaqësuesi i saj i autorizuar, Faik Sylejmani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 264/2015, të 9 dhjetorit 2015, i cili i është dorëzuar parashtrueses të kërkesës më 31 dhjetor 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtrueses të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe me nenin 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 29 prill 2016, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 11 maj 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërzhaliu-Krasniqi.
7. Më 31 maj 2016, Gjykata njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 15 shtator 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi njëzëri Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 17 qershor 2010, ka ndodhur një aksident i komunikacionit në të cilin personi I. A. ka pësuar lëndime të rënda trupore të cilat rezultuan në pasoja të përhershme. Komisioni për vlerësimin e dëmit ka konstatuar se personi I. A. është viktimë e aksidentit të trafikut të shkaktuar nga një person i tretë. Për sa u përket lëndimeve të marra, Komisioni ka konstatuar se personi I. A., *“ka lëndime të rënda trupore që zvogëlojnë aktivitetin e tij jetësor për 100%”*.
10. Në një datë të pacaktuar në vitin 2013, I.A. ka ngritur padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë për kompensimin e dëmit kundër parashtrueses së kërkesës (Byrosë Kosovare të Sigurimit).

11. Më 23 tetor 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë nxori Aktgjykimin [C. nr. 2745/10] me të cilin aprovoi në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë për pagesën e kompensimit I. A..
12. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata Themelore pranoi paditë dhe të drejtën për kompensim për dëmin material dhe jomaterial për të dy, për I. A. dhe për bashkëshorten e tij, si dhe të drejtën për kompensim në emër të dhimbjes shpirtërore për prindërit dhe për fëmijët e I. A.-së, në vlerë totale prej rreth 300.000 euro. Sipas parashtrueses së kërkesës, kjo vlerë tejkalonte limitin maksimal të përcaktuar për person *“në rastin e dëmtimit trupor, shëndetësor ose të vdekjes”* dhe rrjedhimisht, ishte në kundërshtim me rregullin 3 për ndryshimin e Rregullorës për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).
13. Në afatin ligjor, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, të 23 tetorit 2013, për shkak të shkeljes së të drejtës procedurale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke rekomanduar që Gjykata e Apelit të vendosë që të kthejë rastin për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.
14. Më 25 maj 2015, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin [Ac. nr. 2115/2014], me të cilin ankesën e parashtrueses së kërkesës e aprovoi vetëm në pjesën që ka të bëjë me interesin që duhet të llogaritet në kompensimin e caktuar, ndërsa pjesët e tjera të ankesës së parashtrueses së kërkesës i refuzoi si të pabazuara dhe e konfirmoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, të 23 tetorit 2013.
15. Më 1 korrik 2015, parashtruesja e kërkesës paraqiti në Gjykatën Supreme kërkesën për revizion për shkak të shkeljeve esenciale të së drejtës procedurale dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
16. Më 9 dhjetor 2015, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin [Rev. nr. 264/2015], me të cilin e pranoi kërkesën për revizion të parashtrueses së kërkesës dhe i ndryshoi aktgjykimet e Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 2115/2014], të 25 majit 2015, dhe të Gjykatës Themelore [C. nr. 2745/2010], të 23 tetorit 2013, në pjesën e cila i referohet lartësisë së kompensimit të caktuar.
17. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme ka ulur vlerën e tërësishme të kompensimit dhe, ndryshe nga interpretimi i Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, Gjykata Supreme mbështeti interpretimin e parashtrueses së kërkesës përkitazi me Rregulloren.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesja e kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme i është shkelur neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] si dhe neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe neni 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ. Parashtruesja e kërkesës thekson se *“është vetëm pjesërisht e pakënaqur me vendimin e Gjykatës Supreme dhe atë*

në pjesën e cila ka të bëjë me lartësinë e kompensimit të caktuar për shpenzimet materiale”.

Pranueshmëria e kërkesës

19. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i plotëson kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
20. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara], i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

(...)

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

21. Gjykata thekson se, në pajtim me nenin 21.4 të Kushtetutës, i cili përcakton se *“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”*, parashtruesja e kërkesës, si person juridik, ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke iu referuar të drejtave themelore që zbatohen për individët dhe subjektet juridike (shih, *mutatis mutandis*, Aktvendimi i 27 janarit 2010, kërkesa KI41/09, AAB-RIINVEST Universiteti SHPK, Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës).

22. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

23. Gjykata i referohet edhe rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

(1) “Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij;”.

[...]

24. Gjykata vëren që parashtruesja e kërkesës pretendon që limitet maksimale të kompensimit, të parapara me Rregullore, zbatohen vetëm për personin e lënduar dhe sipas asaj, kompensimi nuk mund të tejkalojë shumën prej 100.000 euro. Parashtruesja e kërkesës pretendon *“se në rastin konkret duhet të respektohet neni 2 pika a e rregullit 3 të BQK-së në të cilën specifikohet se në rast të lëndimit trupor dhe shëndetit apo në rastin e vdekjes për person për të gjitha automjetet e tjera kompania e cila është obliguar ta përmbush detyrimin ndaj të dëmtuarit nuk duhet ta kaloj shumën e përcaktuar me rregullin”.*
25. Gjykata vëren se në arsyetimin e saj, Gjykata Supreme mbështet pretendimet e parashtrueses së kërkesës përkitazi me interpretimin e Rregullores. Në dispozitivin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, ndër të tjera, thuhet:
- “Nga neni 2 pika (a) të Rregullit 3 të SQK-së të datës 25 qershor 2004, për ndryshimin e Rregullit 3 për sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjësisë të datës 27 shkurt 2003, rezulton se për rastin e vdekjes, të lëndimit trupor dhe dëmtimit të shëndetit për një person, mbulesa siguruese është 100.000 €, ndërsa shuma prej 300.000 €, është mbulesë siguruese për të gjitha automjetet shumë kjo e cila nuk ka të bëjë me rastin kur në aksident të komunikacionit është lënduar vetëm një person me automjet. Për këtë arsye, Gjykata Supreme gjen se është i bazuar pretendimi i revizionit për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, nga se është tejkaluar mbulesa siguruese me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësve. Gjykata Supreme e Kosovës, gjen se aktgjykimet e gjykatës së shkallës më të ulët doemos duhet të ndryshohen, ashtu që në shumën e gjykuar, të zbritet avansi i të paditurës i paguar paditësit I. A., dhe me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësve nuk mund të tejkalohet mbulesa e sigurimit e përcaktuar me dispozitën e lartpërmendur të Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisë”.*
26. Gjykata, gjithashtu, vëren që përkundër faktit që arsyetimi i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme mbështet interpretimin e Rregullores nga parashtruesja e kërkesës, kjo e fundit megjithatë pretendon që llogaritja e vlerës së kompensimit nga Gjykata Supreme akoma tejkalon limitin maksimal prej 100.000 euro dhe, si rezultat ky Aktgjykim shkel të drejtat e saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të parapara me nenin 31 të Kushtetutës.
27. Përkitazi me pretendimin e parashtrueses së kërkesës se llogaritja e shumës për kompensim siç është përcaktuar nga Gjykata Supreme e Kosovës bie në kundërshtim me arsyetimet e veta, Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është gjykatë e shkallës së katërt e as Gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se përcaktimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është brenda juridiksionit të plotë të gjykatave të rregullta.

28. Gjykata rithekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit, që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo gjatë zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për atë sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria).
29. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës përpiket që pretendimet e saj për shkeljen e nenit 31 [E drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës t'i justifikojë me argumentet e njëjta të cilat tashmë i kishte paraqitur dhe trajtuar gjerësisht para gjykatave të rregullta gjatë procedurës së rregullt gjyqësore, të cilat tashmë kanë qenë objekt i analizës së hollësishme dhe të arsyetuara detajisht në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme.
30. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të zëvendësojë vlerësimin e saj të fakteve me ato të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave të vlerësojnë provat të cilat i kanë në dispozicion të tyre. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (Shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).
31. Kërkesa e parashtrueses nuk argumenton se gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo në mënyrë të padrejtë. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron që gjykatat e rregullta kanë respektuar të drejtën e parashtrueses për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
32. Për më tepër, Gjykata më tej vëren se gjykatat e rregullta kanë trajtuar gjerësisht çështjen e interpretimit të Rregullores, ku Gjykata Supreme ka dhënë një interpretim përfundimtar, duke ndryshuar aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit dhe duke konfirmuar qëndrimin e mbajtur nga ana e parashtrueses përgjatë procedurave në gjykatat e rregullta.
33. Gjykata thekson se fakti që parashtruesja e kërkesës është e pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mund vetvetiu të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e dispozitave të Kushtetutës (shih rastin *Mezôtúr-Tiszazug Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
34. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës, gjithashtu, pretendon se i është shkelur e drejta për mbrojtje gjyqësore të të drejtave, siç është e përcaktuar me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës. Ky nen parashikon:

“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.
35. Gjykata rikujton se neni 54 i Kushtetutës ka të bëjë me të drejtën për mbrojtje gjyqësore kundër shkeljes së të drejtave themelore të mbrojtura me Kushtetutë.

Pasi që ka konkluduar se pretendimi i parashtrueses së kërkesës për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm është i pabazuar, Gjykata gjen se ushtrimi i të drejtës për mjete efektive ligjore nuk mund të zbatohet.

36. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk e ka mbështetur me prova dhe as nuk e ka arsyetuar mjaftueshëm pretendimin e saj për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, specifikisht, për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] si dhe të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, sepse faktet e paraqitura nga ajo në asnjë mënyrë nuk tregojnë që gjykatat e rregullta i kanë mohuar asaj të drejtat e garantuara me Kushtetutë.
37. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, parashihet me nenin 48 të Ligjit dhe më tej specifikohet me kriteret e pranueshmërisë, rregullat 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 15 shtator 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Gresa Caka-Nimani



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi